PSH.nr.959/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "K.S Besa Security" SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të" me nr. të prokurimit: 613-20-6418-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Lipjan", më datën: 08.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "K.S Besa Security" SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të" me nr. të prokurimit: 613-20-6418-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Lipjan".

II. OBLIGOHET, AK KK Lipjan, ti bëj ndryshimet në dosje të tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysh udhëzimet e dhëna si në këtë vendim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të" me nr. të prokurimit: 613-20-6418-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Lipjan".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "K.S Besa Security" SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "K.S Besa Security"SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 17.11.2020 me nr. 959/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të" me nr. të prokurimit: 613-20-6418-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Lipjan", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 9, 27, 28, 53 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe pika 39 parag.4 e RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:
Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Si rekapitullim, Eksperti Shqyrtues pas bashkëbisedimit në telefon me zyrtarët e Autoritetit Kontraktues, gjegjësisht ata të Njësisë Kërkuese, këta të fundit kanë bërë të ditur që si rezultat i një investimi të Autoritetit Kontraktues për furnizim dhe instalim me llaptop dhe projektorë nëpër plasët e shkollave për të cilat është iniciuar ky aktivitet i prokurimit (instalimit dhe montimit të sistemit të alarmit), rezulton edhe numri i zonave të paraqitura në paramasë me gjithsej 640 sosh. Do të thotë, sipas AK-së, paramasa është strukturuar në atë mënyrë që mbulueshmëria e alarmit të jetë edhe nëpër secilën klasë (marrë parasysh që shumë prej tyre janë në pozicion që dritaret kanë qasje nga rruga), e jo vetëm korridoreve dhe sallës së arsimtarëve siç edhe është praktikuar më herët. Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues gjoja që AK ka vendosur kritere

diskriminuese dhe të panevojshme të cilat eliminojnë konkurrencën e lirë dhe nuk janë as ekonomike dhe efikase për Autoritetin Kontraktues, kritere këto në lidhje me pozicionet 1, 2, 3, 4 dhe 9 në paramasë, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rishikimit të dosjes së tenderit, gjen pretendimet si pjesërisht të bazuara. Arsyetimi vijon si më tutje: Konform dispozitave ligjore të RRUOPP, gjegjësisht pikave 20.3 dhe 20.4, specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Pas shqyrtimit të dosjes, konkretisht specifikimeve teknike të shënuara në paramasë, vërehet një kufi i gjerë, respektivisht i papërcaktuar në mes të sasisë minimale dhe maksimale të numrit të zonave që paneli i alarmit duhet të mbështesë. Një interpretim i tillë vlen edhe për pretendimet e tjera, gjegjësisht pozicioneve ku vlerat e sasive të përcaktuara janë të përgjithësuara. Do të thotë, dizajnimi i tillë i paramasës e bën të vështirë një vlerësim objektiv të ofertave pasi që vë në lajthitje operatorët ekonomik sa i përket specifikimeve teknike të produkteve që ofertojnë dhe lë hapësirë në interpretim dhe vlerësim në lidhje me cilësinë, meritat teknike dhe karakteristikat funksionale të produktit në fjalë, gjë që është në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së. Specifikimet teknike duhet theksuar për aq sa janë të mundura duke ju referuar standardeve të mirënjohura por mund të formulohen gjithashtu në aspektin e përformancës apo kërkesave funksionale, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 te LPP-së. Sipas sqarimeve të mësipërme dhe në mbështetje të Nenit 114, paragrafit 2, rekomandohet që AK të ndërmarr veprime korrigjuese me qëllim që të definohen qartë kërkesat dhe që specifikimet teknike në këtë aktivitet të jenë konform Nenit 28 të LPP-së. Kjo me qëllim të ofrimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit në këtë aktivitet të prokurimit. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që Autoriteti Kontraktues të bëjë korrigjimet e duhura përkitazi me sqarimet e mësipërme dhe të zgjatet afati për dorëzim të ofertave nga data në të cilën jepen informatat përkatëse të përditësuara, konform rregullave të LPP-së dhe RRUOPP.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme konform konstatimeve ankimore nga Eksperti.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 04.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Departamenti i Prokurimit në Lipjan në bazë të kërkesës së Drejtorisë Arsimit, procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e kontraktuesit për: Instalimi dhe monitorimi sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të me nr. të prokurimit 613 -20-6418-221. Ky tender ka qenë i publikuar në faqen e KRPP-së, respektivisht në platformën elektronike e-prokurimi më 28.10.2020 kurse hapja e ofertave është planifikuar për datë 17.1 1.2020. Me të njëjtën datë kemi ankesë në OSLIP nga pala e interesuar K.S. Besa Security dhe nuk kemi bërë hapje te tenderëve. Më datë 02.12.2020 kemi pranuar vlerësimin nga ana e ekspertit shqyrtues për ankesën nga pala e interesuar K.S. Besa Security SHPK, ankesën e Kompanisë së Sigurimeve Besa Security, e vlerëson si pjesërisht e bazuar por pa e argumentuar se cilat kritere janë diskriminuese, Për këtë ne nuk pajtohemi me vlerësimin e ekspertit shqyrtues se specifikat e përshkruara në paramasë janë diskriminuese. Eksperti i cekë vetëm pozicionet 1,2,3,4 dhe pozicioni 9 që mendon se janë diskriminuese por nuk e cekë askund cila pjesë është diskriminuese ose pse janë diskriminuese. Eksperti e cekë se ka komunikuar me hartuesin e kësaj paramane nga njësia kërkuese, i cili deklaron se për sigurim te institucioneve arsimore janë të nevojshme ato pajisje dhe kushte të cilat janë të përshkruara në paramasë. Me respekt

Operatori Ekonomik "K.S Besa Security" SH.P.K-Prishtinë me datë 04.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe konform ekspertit shqyrtues sqaron se njësia kërkuese kanë bërë të ditur që si rezultat i një investimi të Autoritetit Kontraktues për furnizim dhe instalim me llaptop dhe projektorë nëpër klasat e shkollave për të cilat është iniciuar ky aktivitet i prokurimit (instalimit dhe montimit të sistemit të alarmit), rezulton edhe numri i zonave të paraqitura në para masë me gjithsej 640 sosh. Do të thotë, sipas AK-së, para masa është strukturuar në atë mënyrë që mbulueshmëria e alarmit të jetë edhe nëpër secilën klasë (marrë parasysh që shumë prej tyre janë në pozicion që dritaret kanë qasje nga rruga), e jo vetëm korridoreve dhe sallës së arsimtarëve siç edhe është praktikuar më herët.
Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues, gjoja që AK ka vendosur kritere diskriminuese dhe të panevojshme të cilat eliminojnë konkurrencën e lirë dhe nuk janë as ekonomike dhe efikase për Autoritetin Kontraktues, kritere këto në lidhje me pozicionet 1, 2, 3, 4 dhe 9 në paramasë. Paneli Shqyrtues konform

ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rishikimit të dosjes së tenderit, gjen pretendimet si pjesërisht të bazuara konform dispozitave ligjore të RRUOPP, gjegjësisht pikave 20.3 dhe 20.4, specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Pas shqyrtimit të dosjes, konkretisht specifikimeve teknike të shënuara në paramasë, vërehet një kufi i gjerë, respektivisht i papërcaktuar në mes të sasisë minimale dhe maksimale të numrit të zonave që paneli i alarmit duhet të mbështesë. Një interpretim i tillë vlen edhe për pretendimet e tjera, gjegjësisht pozicioneve ku vlerat e sasive të përcaktuara janë të përgjithësuara. Do të thotë, dizajnimi i tillë i paramasës e benë të vështirë një vlerësim objektiv të ofertave pasi që vë në lajthitje operatorët ekonomik sa i përket specifikimeve teknike të produkteve që ofertojnë dhe lë hapësirë në interpretim dhe vlerësim në lidhje me cilësinë, meritat teknike dhe karakteristikat funksionale të produktit në fjalë, gjë që është në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së. Specifikimet teknike duhet theksuar për aq sa janë të mundura duke ju referuar standardeve të mirënjohura por mund të formulohen gjithashtu në aspektin e përformancës apo kërkesave funksionale, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 tw LPP-së.

Paneli Shqyrtues sipas sqarimeve të mësipërme konsideron që AK të ndërmarr veprime korrigjuese me qëllim që të definohen qartë kërkesat dhe që specifikimet teknike në këtë aktivitet të jenë konform nenit 28 të LPP-së. Kjo me qëllim të ofrimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit në këtë aktivitet të prokurimit. Pra, AK duhet ti beje korrigjimet e duhura përkitazi me sqarimet e mësipërme dhe të zgjatet afati për dorëzim të ofertave.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Lipjan";

1x1 OE "K.S Besa Security"SH.P.K-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.